VENDIM
Nr. 75, datë 6.7.2016

PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN "MBI MINIMUMIN E REZERVËS SË DETYRUAR MBAJTUR NË BANKËN E SHQIPËRISË NGA BANKAT"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 19 dhe nenit 43, shkronjat "a" dhe "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar, bazuar në propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Mbi minimumin e rezervës së detyruar mbajtur në Bankën e Shqipërisë nga bankat", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 29, datë 16.5.2012, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 12/1, përmbajtja e pikës 2 ndryshon si më poshtë:

"Teprica e llogarisë rezervë në euro është diferenca e gjendjes në llogarinë rezervë me rezervën e detyruar, e llogaritur çdo ditë".

b) Në nenin 12/1, pas pikës 2 shtohet pika 2/a me përmbajtje si më poshtë:

"Teprica e llogarisë rezervë në dollarë amerikanë është diferenca e gjendjes në llogarinë rezervë me rezervën e detyruar, e llogaritur çdo ditë, por jo më e vogël se niveli minimal i tepricës".

c) Në nenin 12/1, pika 3 ndryshon me përmbajtje si më poshtë:

"Banka e Shqipërisë remuneron tepricën në euro në gjithë shumën e saj. Banka e Shqipërisë remuneron tepricat në llogaritë rezervë në lekë dhe në dollarë amerikanë vetëm në rastet kur tejkalohet niveli minimal i saj, ku si i tillë konsiderohet shuma për të cilën bankat nuk remunerohen. Si nivel minimal për rezervën e detyruar në lekë dhe USD konsiderohen përkatësisht shumat 50 milionë lekë dhe 500,000.00 USD".

2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit me publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin në Buletinin Zyrtar dhe në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 26.9.2016.

KRYETARI

Gent Sejko